REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 2449/1 Prot., datë 15.10.2026

Nr. 196521 Prot., datë 16.10.2026

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

"PËR LUFTËN KUNDËR PIRATERISË AUDIOVIZIVE DHE RRITJEN E SIGURISË NË HAPËSIRËN DIGJITALE"

NDËRMJET:

Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), e përfaqësuar znj. Armela Krasniqi, në cilësinë e Kryetares, me adresë Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, KP 1010, Tiranë";

dhe

Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, e përfaqësuar nga z. Besmir Beja, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, me adresë Autostrada Tiranë-Durrës, Km1, Qendra Paiton, Tiranë;

së bashku referuar si "Palët".

MBËSHTETUR NË, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; ligjin nr. 97/2013, "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar, veçanërisht nenin 84 për aktivitetet e ndaluara lidhur me aksesin e kushtëzuar; ligjin nr. 102/2014, "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", të ndryshuar; aktet nënligjore në zbatim të tyre;

MEQËNESE:

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), organ i pavarur ka mision rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe të shërbimeve të platformave të shpërndarjes së videove, në territorin e Republikës së Shqipërisë,

Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, ka mision kryesor mbrojtja e interesave financiarë dhe mjedisorë të Republikës së Shqipërisë nga tregtia e padrejtë dhe e paligjshme, duke mbështetur ndërkohë aktivitetin e ligjshëm të biznesit mbështetur në parimin e bashkëpunimit përmes përforcimit të bashkëpunimit edhe për mbrojtjen e pronësisë intelektuale.

Duke marrë në konsideratë të gjitha detyrimet ligjore të palëve për parandalimin dhe luftën kundër piraterisë digjitale audiovizive dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Bien dakort, të hartojnë dhe të nënshkruajnë këtë memorandum bashkëpunimi, me përfaqësim në nivelin e titullarit të institucionit me përmbajtjen si vijon:

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Ky Memorandum përcakton mënyrat e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacionit ndërmjet Palëve për identifikimin dhe vlerësimin, brenda kompetencave përkatëse, të mallrave që i nënshtrohen mbikëqyrjes ose kontrollit doganor dhe për të cilat ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dyshimi që lidhen me pajisje të ndaluara për akses të paautorizuar në shërbime audiovizive.

2. Bashkëpunimi përqendrohet te pajisjet ose programet e projektuara ose të përshtatura për të mundësuar akses në një shërbim të mbrojtur në formë të kuptueshme, pa autorizimin e ofruesit të shërbimit, sipas nenit 84 të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar, si dhe te rastet e tjera që hyjnë në kompetencat ligjore të Palëve.

3. Ky Memorandum nuk synon të krijojë një mekanizëm të përgjithshëm kontrolli për importin ose eksportin e pajisjeve elektronike dhe nuk nënkupton se pajisjet e përdorimit të zakonshëm përbëjnë, në vetvete, shkelje të ligjit.

Neni 2

Parimet e bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve bazohet në:

a) respektimin e Kushtetutës dhe legjislacionit në fuqi;

b) respektimin e kompetencave ligjore dhe pavarësisë institucionale të secilës Palë;

c) ligjshmërinë, domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e shkëmbimit të informacionit;

ç) ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave;

d) mosndërhyrjen e njërës Palë në procedurat dhe vendimmarrjen që i përkasin Palës tjetër.

Ky Memorandum nuk përbën transferim, delegim ose zgjerim të kompetencave ligjore të asnjërës Palë dhe nuk krijon kompetenca të reja për kontroll, ndalim apo sekuestrim mallrash.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

Palët bashkëpunojnë, sipas kompetencave të tyre, për:

a) shkëmbimin e informacionit për pajisje ose programe që, në bazë të karakteristikave dhe funksionimit të tyre, mund të përbëjnë pajisje të ndaluara sipas nenit 84 të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar;

b) dhënien e asistencës teknike nga AMA, me kërkesë të DPD-së, për të kuptuar funksionimin dhe përdorimin e pajisjeve ose programeve të identifikuara;

c) shkëmbimin e informacionit mbi mënyrat dhe teknologjitë e reja që përdoren për akses të paautorizuar në shërbime audiovizive;

ç) organizimin e trajnimeve dhe shkëmbimin e praktikave të mira për çështjet që lidhen me objektin e këtij Memorandumi.

Neni 4

Detyrat dhe përgjegjësitë e AMA-s

Në kuadër të këtij Memorandumi, AMA:

a) përcjell te DPD-ja informacionin teknik dhe të dhënat e disponueshme për pajisje ose programe që, bazuar në funksionin, konfigurimin ose mënyrën e përdorimit të tyre, mund të përmbushin përkufizimin e pajisjes së ndaluar sipas nenit 84 të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar;

b) përshkruan, sa herë që është e mundur, karakteristikat konkrete që e dallojnë pajisjen ose programin e dyshuar nga pajisjet e zakonshme me përdorim të përgjithshëm;

c) jep, me kërkesë të DPD-së dhe brenda kompetencave e burimeve të disponueshme, sqarime dhe asistencë teknike për vlerësimin e rastit;

ç) informon DPD-në për ndryshimet teknologjike dhe format e reja të aksesit të paautorizuar në shërbime audiovizive, kur ky informacion është relevant për veprimtarinë doganore;

Informacioni i AMA-s ka karakter teknik dhe informues.

Neni 5

Detyrat dhe përgjegjësitë e DPD-së

Në kuadër të këtij Memorandumi, DPD-ja:

a) shqyrton informacionin e përcjellë nga AMA-ja, në përputhje me legjislacionin doganor dhe procedurat përkatëse;

b) kryen kontrollet, verifikimet dhe veprimet doganore vetëm nëpërmjet strukturave kompetente dhe sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

c) mund t'i kërkojë AMA-s informacion ose ekspertizë teknike shtesë, kur kjo është e nevojshme dhe e përshtatshme për shqyrtimin e një rasti konkret;

ç) informon AMA-n për ecurinë ose rezultatin e referimit, në masën që lejohet nga legjislacioni në fuqi;

Neni 6

Procedura e referimit dhe informacioni i nevojshëm

1. Kur AMA disponon informacion konkret që mund të jetë i rëndësishëm për ushtrimin e kompetencave doganore, ajo ia përcjell atë DPD-së për vlerësim. Referimi duhet të lidhet me mallra konkrete ose me një rast të identifikueshëm dhe jo me kategori të përgjithshme pajisjesh vetëm për shkak se ato mund të kenë funksione audio, video, transmetimi ose ruajtjeje të të dhënave.

2. Në varësi të informacionit të disponueshëm dhe të rastit konkret, referimi i AMA-s mund të përmbajë:

a) përshkrimin dhe identifikimin e pajisjes ose programit, përfshirë markën, modelin dhe të dhëna të tjera identifikuese, kur disponohen;

b) karakteristikat teknike dhe funksionet konkrete që krijojnë dyshimin se pajisja është projektuar ose përshtatur për akses të paautorizuar në një shërbim të mbrojtur;

c) shpjegimin e mënyrës së funksionimit dhe të përdorimit të pajisjes ose programit;

ç) burimin dhe arsyetimin teknik të dyshimit, së bashku me dokumentacionin mbështetës që mund të vihet ligjërisht në dispozicion;

d) të dhëna identifikuese për subjektin, prodhuesin, importuesin ose shpërndarësin, vetëm nëse këto të dhëna janë të disponueshme në mënyrë të ligjshme.

3. DPD-ja vlerëson në mënyrë të pavarur informacionin e marrë, përfshirë përshkrimin e mallrave dhe klasifikimin tarifor përkatës, sipas kompetencave dhe procedurave doganore. Kur informacioni është i pamjaftueshëm, DPD-ja mund t'i kërkojë AMA-s sqarime teknike shtesë.

4. Veprimet doganore ndërmerren vetëm kur plotësohen kushtet dhe kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mallrat që janë ose duhet të ishin objekt i mbikëqyrjes apo kontrollit doganor.

Neni 7

Kontrollet doganore dhe asistenca teknike

1. Kontrollet dhe verifikimet doganore kryhen, në përputhje me Kodin Doganor dhe aktet nënligjore në fuqi.

2. Me kërkesë të DPD-së, AMA mund të ofrojë asistencë teknike sa i përket karakteristikave dhe funksionimit të pajisjeve ose programeve që lidhen me shërbimet audiovizive. Asistenca jepet veçmas nga procedura e kontrollit dhe nuk cenon kompetencën vendimmarrëse të DPD-së.

3. Çdo masë ndaj mallrave merret nga DPD-ja vetëm mbi bazën e ligjit dhe pas përmbushjes së kushteve procedurale përkatëse.

Neni 8

Shkëmbimi i informacionit dhe konfidencialiteti

1.Palët shkëmbejnë vetëm informacionin e nevojshëm, të përshtatshëm dhe të disponueshëm për realizimin e qëllimit të këtij Memorandumi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Informacioni i shkëmbyer përdoret vetëm për qëllimin për të cilin është përcjellë, përveç rasteve kur përdorimi ose komunikimi i mëtejshëm kërkohet ose lejohet nga ligji.

3. Palët marrin masa të përshtatshme për ruajtjen e informacionit konfidencial, sekretit tregtar, të dhënave personale dhe çdo informacioni tjetër të mbrojtur. Asnjë dispozitë e këtij Memorandumi nuk detyron një Palë të japë informacion që nuk mund të bëhet i disponueshëm sipas ligjit.

Neni 9

Pikat e kontaktit

1. Secila Palë cakton, me shkresë zyrtare, një pikë kontakti institucionale për komunikimin dhe koordinimin e referimeve në kuadër të këtij Memorandumi.

2. Pikat e kontaktit koordinojnë përcjelljen e kërkesave, përgjigjeve dhe dokumentacionit përkatës, duke respektuar rregullat e sigurisë së informacionit dhe procedurat e brendshme të secilës Palë.

Neni 10

Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve

Palët mund të organizojnë trajnime të përbashkëta, shkëmbim ekspertize dhe aktivitete profesionale për identifikimin teknik të pajisjeve të ndaluara për akses të paautorizuar në shërbime audiovizive, si dhe për njohjen e procedurave doganore përkatëse.

Neni 11

Vlerësimi i bashkëpunimit

Palët mund të zhvillojnë takime periodike për të vlerësuar zbatimin e Memorandumit, duke marrë në konsideratë numrin dhe cilësinë e referimeve, nevojat për sqarime teknike, rezultatet e bashkëpunimit dhe mundësitë për përmirësimin e procedurave. Vlerësimi kryhet pa cenuar konfidencialitetin e rasteve individuale dhe kompetencat ligjore të secilës Palë.

Neni 12

Dispozita përfundimtare

1. Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët dhe lidhet për një periudhë të pacaktuar.

2. Memorandumi mund të ndryshohet ose plotësohet vetëm me marrëveshje me shkrim të Palëve.

3. Secila Palë mund të tërhiqet nga Memorandumi duke njoftuar me shkrim Palën tjetër të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara. Tërheqja nuk cenon trajtimin e informacionit të marrë më parë dhe detyrimet e konfidencialitetit që vazhdojnë të zbatohen sipas ligjit.

4. Çdo çështje që lidhet me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi trajtohet me mirëkuptim ndërmjet Palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rast mospërputhjeje ndërmjet Memorandumit dhe legjislacionit, prevalon legjislacioni në fuqi.

5.Nënshkruar më ___/___/___ në 4 (katër) kopje origjinale njësoj të barasvlershme.

PËR AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE

KRYETAR

Armela Krasniqi

PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Besmir Beja